

Syllabusi i lëndës

Lënda: Kuran I

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 7

Statusi i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 101

Fondi i orëve: 3+3

Viti akademik: 2015/2016

Semestri: -I-rë

Mësimdhënësi: Hfz. Mr. sci. Afrim Bulliqi

Përshkrim i shkurtër i lëndës:

Lënda e Kuranit I është një nga lëndët më vitale të FSI-së.

Kuran I është lënda nëpërmjet së cilës studenti i zhvillon kompetencat e leximit të drejtë të Kur'anit famëlartë.

Për më tepër ai do të qartësoj vendartikulimet dhe mënyrat e artikulimit të shkronjave arabe.

Po ashtu do të përvetsoj edhe rregullat e veçanta që lidhen me disa shkronja të alfabetit arab.

Para së gjithash ai do të shtoj edhe më tepër dashurinë dhe respektin për Kur'anin famëlartë

Qëllimi i lëndës

Pajisja e studentëve me njohuri bazë rreth vlerës së leximit-këndimit të Kuranit famëlartë rregullave dhe konditave të drejtkëndimit që dalin nga shkenca përkatëse e njohur me emrin "Texhvid". Dhe atë me aftësimin e studentëve në artikulimin e nyjëtimin e saktë të shkronjave arabe, duke respektuar tingujt dhe veçoritë e akustikës burimore e natyrore të tyre dhe më pas lidhjen e tyre në fjalë dhe leximin e rrjedhshëm të atyre fjalëve në fjalitë e ajeteve-verseteve Kur'anore. Po ashtu pritet që të avancohen këto kompetenca pastaj edhe me rregullat e veçanta precize që dalin nga shkenca e Texhvidit të ndërlidhura me shkrirjet, formimet dhe zgjatimet e veçanta të disa tingujve komfor standardeve që përcakton kjo lëmi. Dhe aftësimi kulmor arrihet duke i zbritur të gjitha këto kompetenca, në kontuniitet me aspektin teorik, në rrafshin e praktikës nga ana e studentëve nën vëzhgimin dhe bashkëpunimin e vazhduar të profesorit. E tëra kjo pritet të rezultojë me nivel cilësor e të kënaqshëm të drejt lexim-këndimit të Kur'anit famëlartë nga ana e studentëve që përcjellin dhe angazhohen në këtë kurs.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje të:

Të përshkruaj rregullat e lexim-këndimit të drejt të Kur'anit famëlartë.

Të krahasoj veçoritë e leximit të saktë me atë jo të saktë.

Të diskutoj rreth vlerave, rëndësisë dhe rregullave të leximit të Kur'anit famëlartë.

Të argumentojë- të arsyetojë të gjitha kompetencat e fituara me argumentet përkatëse.

Të aftësoj të tjerët me të njëjtat kompetenca pas përfundimit në tërësi me të gjithë semestrat e tij.

Metodologjia e mësimdhënies:

Mësimi do të zhvillohet në formë të ligjëratave, stimulimit të studentëve në diskutime interaktive, duke bërë pyetje dhe analiza në kuadër të ligjëratës së mbajtur. Po ashtu do të shfrytëzohen pajisjet e projektorëve për prezantimin e njohurive në formë të slljaveve me programin Power Point. Po ashtu do të mbahen seminare dhe ese të ndryshme, të cilat do të prezantohen në mënyrë individuale por edhe grupore, dhe teste të vetëvlerësimit. Dhe të tëra këto do të plotësohen me zbatimin e tyre në praktikë duke i implementuar në lexim-këndimin e studentëve para profesorit. Gjithashtu studentët kanë mundësi që gjatë përgatitjes së lëndës të kontaktojnë me profesorin dhe të marrin udhëzime me qëllim të arritjes së cilësisë dhe rezultateve në mësim dhe sukses të studentëve.

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë: Hyrje, Njohja me syllabusin, metoda, organizimi, kërkesat dhe vlerësimi.

Shqyrtime të përgjithshme: Hyrje në shkencën e Texhvidit, burimi, rëndësia dhe fryti i saj. Njoftim me nivelin e leximit të studentëve në praktikë.

Rëndësia e leximit të Kur'anit të madhërishëm, mënyrat e këndimit të tij dhe rregullat e atij që lexon dhe dëgjon atë, - lexim-këndim.

Literatura: Kur'ani famëlartë 1-4 , Emin Behrami, Shkenca e Texhvidit f. 09-19. *(Ky libër në vazhdim do të jetë literaturë bazë e zhvillimit të aspektit teorik, andaj do të mjaftohemi vetëm me cekjen e faqeve. Ndërsa aspektin praktik do ta zhvillojmë duke lexuar nga 4 faqe të Kur'anit famëlartë për çdo javë, kështuqë më nuk do ta përmendi fare).*

Java e dytë: Këndimi i Kur'anit me zë të bukur. Rregullat e el- istiadhës dhe el-besmeles. Sexhdeja e leximit, norma, forma dhe vendet saj përkatëse në Kur'an. Tekbiri gjatë leximit burimi, norma dhe vendet e tij. Te bërit hatme (përfunduarit) Kur'anin famëlartë, për sa kohë duhet të bëhet, praktika e mendimit e dijetarëve për këtë çështje dhe duaja e hatmes. Diskutime dhe përsëritje të materies së deritashme, lexim-këndim.

Literatura: (f. 20-27)

Java e tretë: Alfabeti arab, karakteristikat dhe specifikat e tij. Vendnyjëtimet e shkronjave arabe. Vendnyjëtimi i grykës e fytit dhe shkronjat e tyre përkatëse. Vendnyjëtimi i gjuhës, i buzëve dhe vrimat e hundës, shkronjat e tyre e përkatëse. Diskutime dhe përsëritje të materies së deritashme, lexim-këndim.

Literatura: (f.27-32).

Java e katërt: Veçoritë e shkronjave arabe. Llojet e veçorive, dhe numri i tyre. Veçoritë e kundërvëna njëra me tjetrën dhe shkronjat e çdo njëres prej tyre (gjithsejt dhjetë) . Veçoritë e pakundërvëna me të tjerat (gjithsejtë shtatë) dhe shkronjat e tyre përkatëse. Shqiptimi i rëndë dhe i lehtë i shkronjave. Zanoret e shkurta dhe rregullat e tyre. Diskutime dhe përsëritje të materies së deritashme, lexim-këndim.

Literatura: (f. 32-40).

Java e pestë: Sukuni, Tenvini, llojet dhe rregullat që ndërlidhen me të. Diskutime dhe përsëritje të dy ligjëratave të fundit. Lexim-këndim. Organizimi i testit të parë, studentët do të ndahen në dy grupe. Zanoret e gjata, llojet dhe rregullat përkatëse të çdo njëres prej tyre. Zanorja e gjatë "a" dhe mënyra e shqiptimit të saj. Lidhja e fjalëve që përfundojnë me "a" të gjatë me fjalët e tjera. Përsëritje të leksioneve të orëve të kaluara, lexim-këndim

Literatura: (f. 41-50).

Java e gjashtë: Zanorja e gjatë "u" dhe rregullat e saj. Zanorja e gjatë "i" dhe rregullat e saj. Rregullat e teshdidit dhe veçoritë e tij me disa shkronja të veçanta. Hemzeja në fillim mes dhe në fund të fjalës . Analiza e rezultateve të testit të mbajtur me anë të bisedës interaktive. Përsëritje të leksioneve të orëve të kaluara, lexim-këndim

Literatura: (f. 50 - 57).

Java e shtatë: Hemzeja e prerë dhe ajo e ndarë, rregullat e çdo njëres prej tyre.. Lami i foljes dhe lami i shquarsisë dhe rregullat e çdo njërit prej tyre. Përsëritje të leksioneve të orëve të kaluara. Lexim-këndim:

Literatura: (f. 57-65).

Java e tetë: Lami i shquarsisë në dy gjendjet e tij dhe mënyra e leximit të tyre. Rregullat e leximit të emrit të Allahut të lartëmadhërisëm. Rregulla e Idhharit të nunit sakin, shkronjat e tij dhe mënyra e shqiptimit të tij. Lexim-këndim.

Literatura: (f. 65-75).

Java e nëntë: Idgami i nunit sakin dhe tenvinit dhe llojet e tij. Idgami me tingull hundor, dhe rregullat e tij. Idgami pa tingull hundor. Rregulla e shndërrimit të nunit sakin dhe tenvinit. Rregulla e shqiptimit të fshehtë të nunit sakin dhe tenvinit. Lexim-këndim.

Literatura: (f.75-82)

Java e dhjetë: Rregullat e mimit sakin. Shqiptimi i qartë i mimit sakin Rregulla e idgamit të mimit sakin. Rregulla e fshehjes së mimit sakin. Përsëritje të leksioneve të orëve të kaluara. Lexim-këndim. Organizimi i testit të dytë.

Literatura: (f.82-86).

Java e njëmbëdhjetë: Rregulla e Idgamit të bashkëtingëlloreve të njëjta.Rregulla e Idgamit të bashkëtingëlloreve të ngjashme. Përsëritje të materies së ligjëratave të kaluara. Lexim-këndim. Diskutimi me studentë rreth rezultateve të pritura dhe të arritura nga testi i dytë.

Literatura: (f. 86-90).

Java e dymbëdhjetë: Rregulla e Idgamit të bashkëtingëlloreve të afërta, llojet dhe specifikat e tyre. Rregullat e veçanta të shqiptimit të shkronjës "Ra". Përkujtim i vendyjtimit të saj. . Përsëritje të materies së ligjëratave të kaluara. Lexim-këndim.

Literatura: (f. 31, 36, 90- 92).

Java e trembëdhjetë: . Shqiptimi rëndë i bashkëtingëllores "ra"..Shqiptimi lehtë i bashkëtingëllores "ra". Përsëritje të materies së ligjëratave të kaluara, Lexim- Këndim

Literatura: (f. 92-96).

Java e katërbëdhjetë: Rregullat dhe rastet kur lejohet të shqiptohet në të dy format, atë të lehtë dhe të rëndë bashkëtingëllorja "ra". Cilësia ettekrir e bashkëtingëllores ra, mënyra e shqiptimit të saktë të saj kur është me teshdid. Lexim- Këndim.

Literatura: (f. 35-36; 96- 99).

Java e pesëmbëdhjetë: Gabimet e fshehta dhe gabimet e hapura në lexim-këndimin e Kuranit.Përmbyllje e semestrit me diskutime interaktive dhe provokim i komptencave të arritura për gjatë këtij cikli ligjëratash.

Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10%

Testi i I- rë 20%

Testi i II- të 20%

Provimi final 50%

Total 100%

Literatura obliguese:

1. Emin Behrami, Shkenca e Texhvidit, Prishtinë, 2000

Literartura shtesë dhe bibliografia:

1. Imam Neveviu, Rijadu Salihin, kapitulli mbi këndimin e Kur'anit.
2. Dr. Qazim Qazimi, Libër mësimi i arabishtes (për fillestar), Prishtinë 2010.
3. Dr. Musli Vërbani, Texhvidi shkenca e të lexuarit (kënduarit) të Kur'anit, Kaçanik 2008.
4. Mahmud Halil elHusari, Ahkam Kiraetil Kuranil Kerim, elMektebetul Mekkije- darul beshair elislamije 1999